



**Republika e Kosovës**  
**Republika e Kosovës - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**

Në pajtim me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Neni 8 i këtij Ligji, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 Për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

<b><u>Titulli i vendit të punës:</u></b>	<b><u>Teknik i Dhëmbëve/Stomatologjisë</u></b>
<b>Grada e vendit të punës;</b>	<b>A-0</b>
<b>Nr. referencës së vendit të punës;</b>	<b>2582</b>
<b>Vendi;</b>	<b>FSK</b>

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Të ndihmoj sipas nevojës, në mirëmbajtjen, shfrytëzimin e pajisjeve dhe aparaturës së shërbimit stomatologjik.
- Të ofrojë shërbimin e duhur si teknik i dhëmbëve/stomatologjisë për personelin e FSK-së.
- T'ë raportoj rreth gjendjes teknike, dhe përshtatshmërisë së pajisjeve në shfrytëzim.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Proceduarat e konkurrimit:**

- Shpallja e konkurrimit është e hapur për të gjithë të interesuarit për aplikim.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Përgatitja e mesme shkollore e mjekësisë-Teknik i Dhëmbëve/Stomatologjisë.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

- Përvojë dhe njohuri pune në fushën përkatëse.
- Njohuri të gjuhës shqipe apo serbe.
- Gjuha angleze( e dëshiruar).
- Përvojë të gjatë pune si Teknik i Stomatologjisë në ndonjë institucion/klinikë spitalore (preferohet të ketë së paku 3 vite përvojë), (e dëshiruar),
- T'i kryej detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet të përdorë maturinë në punë dhe gjatë detyrës me njerëz.
- Duhet të jetë i motivuar dhe me etikë të lartë pune.
- Ai/ajo duhet të posedojë aftësi që të punojë i/e mëvetëshme si dhe të punojë në ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Procesi i rekrutimit për këtë pozitë është i bazuar Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Neni 8 i këtij Ligji, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 14/2011 Për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik.
- Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara, do t'i nënshtrohen shqyrtimit fillestar të aplikacioneve të tyre.
- Kandidatët më të suksesshëm do të përfshihen në listën e shkurtër dhe do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë.
- Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, do t'i nënshtrohen testit me gojë (intervistimit).

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare.
- Data e fundit e aplikimit është 27.05.2016.

- Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Formularët dorëzohen në Departamentin e Personelit personalisht, apo me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Kazerma „ Adem Jashari ”, 10000 Prishtinë, Departamenti i Personelit/Spektori i Rekrutimit dhe Rezervës**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
- Kandidatët duhet t'ia bashkëngjitin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

**Kërkesa specifike:**

- Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Kërkesat e pakompletuara dhe të dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në ueb-faqen e M-FSK-së, [www.mksf-rks.org](http://www.mksf-rks.org) , [www.rks-gov.net/mfsk](http://www.rks-gov.net/mfsk), ku gjendet shpallja e konkursit. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në: 038 200 13 508.**